

Efesianëve

Ndërtimi i njerëzve (4:29–32)

Pas viteve të tëra planifikimi dhe ndërtimi, u hap në Teksas një park beizbolli. Deri para disa javësh parku i vjetër qëndronte pranë të riut. Kur më në fund parku i vjetër u prish, fotografia e tij pas shkatërrimit në gazetë u publikua. Kjo më kujtoi një parim themelor në jetë: Çfarë është ndërtuar me shumë mund dhe djersë për shumë kohë mund të shkatërrohet shumë lehtë në një moment të kohës.

Perëndia na e kujton këtë të vërtetë me anë të këtyre fjalëve të shkruara nga Pali:

Asnjë fjalë e keqe le të mos dalë nga goja juaj, por ajo që është e mirë për ndërtimin, sipas nevojës, që t'ju japë hir atyre që dëgjojnë. Dhe mos e trishtoni Frymën e Shenjtë të Perëndisë, me të cilin u vulosët për ditën e shpengimit. Le të flaket larg jush çdo hidhërim, zemërim, inat, trazirë dhe shpifje me çdo ligësi. Por jini të mirë dhe të mëshirshëm njëri me tjetrin, duke e falur njëri-tjetrin, sikurse edhe Perëndia ju ka falur në Krishtin (4:29–32).

Perëndia do që njerëzit në kishë të ndërtojnë njëri-tjetrin.

Efesianëve 4:29–32 fokusohet në dy gjëra që janë vendimtare për të qenë si Jezusi dhe për t'ju bërë ndërtues të njerëzve: fjalët dhe veprimet tona.

FJALË QË I SHËRBEJNË RITJES SHPIRTËRORE TË TË TJERËVE

Si kristianë, duhet të kemi kujdes për fjalët që

themi. Një mënyrë për të kontrolluar të folurën është të mos themi asnjë «fjalë të keqe» (4:29a). Në greqisht fjala «e keqe» përdoret për të përshkruar ushqim të prishur apo të kalbur. Para disa javësh ekipi i ndihmave të bashkësisë lokale mori një kontigjent frutash. Ndërsa anëtarët e ekipit po i përgatisnin frutat për t'i shpërndarë tek ata që kishin nevojë, dikush vuri re se shumica e tyre ishin të prishura. Mezi dukej nga jashtë, por kur njëri prej tyre preu një pjeshkë u vu re se ajo ishte komplet e kalbur nga brenda. Të gjitha frutat ishin të prishura.

Asnjëri prej nesh nuk dëshiron që të fusë në gojë fruta të kalbura. Na bën të na përzihet kur e mendojmë. Por ne shpesh lejojmë të kemi në gojë atë që është e prishur në sytë e Perëndisë. Kur dikush tregon një barcaletë të ndyrë, blasfemon, thotë një gënjeshtër apo përhap thashetheme, ai po lejon që goja e tij të jetë plot kalbësira.

Si duhet të jenë fjalët tona? Vini re tre udhëzimet e dhëna nga Pali. *Së pari, fjalët tona duhet të ndërtojnë.* Kemi lirinë të flasim vetëm atë fjalë «që është e mirë për ndërtimin» (4:29). Kristianët duhet t'ju përdorin fjalët për të vënë në dukje anët më të mira të të tjerëve.

Së dyti, fjalët tona duhet të jenë të përshtatshme. Ato duhet të thuhet «sipas nevojës» (4:29c). Gjithmonë duhet të mbajmë parasysh të mirën e të tjerëve kur zgjedhim fjalët.

Së treti, fjalët tona duhet të jenë hirplota. Bibla na jep qëllimin e komunikimit verbal me të tjerët: «që t' u japë hir atyre që dëgjojnë» (4:29d). Perëndia derdh hirin e Tij mbi jetët e të tjerëve nëpërmjet fjalëve që ne flasim. Solomoni tha: «Një fjalë e thënë në kohën e duhur është si mollë të arta mbi një enë argjendi» (Fjalët e Urta 25:11).

Sa të rëndësishme janë fjalët tona? Pali na ndihmoi që ta kuptojmë këtë duke sjellë ndjenjat e Frymës së Shenjtë: «Dhe mos e trishtoni Frymën e Shenjtë të Perëndisë, me të cilin u vulosët për ditën e shpengimit» (4:30). Veprime të ndryshme e trishtojnë Frymën e Shenjtë. Një prej tyre është përdorimi i fjalëve në mënyrë të pakontrolluar. Pra, është vendimtare që të tregojmë kujdes kur flasim.

Si do të ndryshonte martesja juaj sikur të flisnit vetëm fjalë inkurajuese ndaj burrit apo gruas tuaj? Si do të ndikonte te fëmijët të folurit në mënyrë të vazhdueshme me fjalë inkurajuese? Si do të ndryshonte kisha lokale sikur të gjithë anëtarët të shmangnin fjalët e «kalbura» dhe të flisnin vetëm fjalë që i shërbejnë ndërtimit dhe inkurajimit të njëri-tjetrit?

VEPRIME QË I SHËRBEJNË RITJES SHPIRTËRORE TË TË TJERËVE

Përkrah të folurës, edhe veprimet tona duhet të ndërtojnë njerëzit. Kjo do të thotë jo vetëm të veprosh në mënyrë pozitive kundrejt të tjerëve, por do të thotë gjithashtu të mos pranosh të veprosh në mënyrë negative kundrejt tyre.

Shmangni veprimet negative. Kristianët duhet të eliminojnë veprimet negative që dëmtojnë njerëzit. Vini re listën e mëposhtme të veprimeve dhe qëndrimeve për të cilat Pali na paralajmëron në vargun 4:31:

1. «*Hidhërim*» – ashpërsi që e bën një njeri zemërak kundrejt të tjerëve
2. «*Zemërim*» – shpërthim i papritur i zemërimit ndaj njerëzve
3. «*Inat*» – armiqësi e thellë dhe e gjatë kundrejt dikujt
4. «*Trazirë*» – të bërtitura me inat ndaj të tjerëve
5. «*Shpifje*» – përhapja e thashethemeve për të prishur emrin e mirë të dikujt
6. «*Ligësi*» – përpyetje e vullnetshme për të

dëmtuar dikë

Në qoftë se nuk e pastroni kurrë shtëpinë ajo bëhet e pistë. Mbajtja pastër e shtëpisë do të thotë të eliminosh plehrat. Pali tha që të heqim nga jeta dhe aktiviteti ynë i përditshëm disa veprime dhe zakone që mund të na infektojnë shpirtin dhe jetën tonë.

Veproni pozitivisht. Pasi radhiti veprimet negative që duhen shmangur, Pali dha tre veprime pozitive që duhet të kryejmë:

1. «*Jini të mirë*» – të mendosh më të mirën për të tjerët dhe të bësh çdo gjë që mundesh për të vënë në pah më të mirën në ta
2. «*Jini të mëshirshëm*» – të jesh i hapur dhe i gatshëm ndaj nevojave të të tjetërve
3. «*Duke e falur njëri-tjetrin*» – të sillesh ndaj gabimeve të të tjerëve ashtu si do që Perëndia të sillet ndaj gabimeve të tua

Një studim i kryer nga Kolegji Kristian në Abilene, Teksas u përqëndrua në adoleshentët brenda kishave të Krishtit në Amerikë. Profesorët studiuan adoleshentët lidhur me përdorimin e drogave të çdo lloji. Vini re një nga përfundimet e arritura prej tyre lidhur me ndërtimin e të tjerëve:

Një nga zbulimet tona më të rëndësishme...është mënyra në të cilën stili dhe mjedisi i një bashkësie të veçantë ndikon te adoleshentët.... Atmosfera pozitive e mbështetjes dhe faljes duket se nxit vetëpërmbytjen dhe përmbytjen seksuale. Një dukuri e ngjashme ndodh edhe me përdorimin e alkolit dhe drogës nga adoleshentët. Adoleshentët në kishat «pozitive»¹ jepen pas drogës dhe pijeve alkolike më pak se sa adoleshentët në kishat «negative»².

Ata që kryen këtë studim arritën në këtë konkluzion:

Meqënëse bashkësia është edhe familje (familja e Perëndisë), mund të ketë ndikim te të rinjtë e saj në mënyrë të ngjashme me ndikimin që ka familja fizike. Kishat që duan të ndikojnë të rinjtë e tyre për mirë duhet të shqyrtojnë atmosferën dhe mesazhet që karakterizojnë bashkësinë lokale.

Një djalë i ri i quajtur Ted lindi në një familje ku të gjithë përveç tij ishin të shurdhër. Ai kurrë nuk e dëgjoji familjen e tij t' i këndoje këngën «*Shumë urime për ty*». Kurrë nuk e dëgjoji të atin t' i fliste fjalë inkurajuese. Ai ishte në njëfarë mënyre

i veçuar nga bota e heshtur e prindërve të tij. Ai filloi të kishte probleme me stresin dhe të mos e kontrollo-nte mirë atë. U bashkua me një grup adoleshentësh që pinin sa deheshin dhe rrinin rrugëve. Ai nuk i krihte më flokët dhe vishte këmisha të grisura dhe mbante dorashka lëkure. Situata e Tedit dukej pa të ardhme. Megjithatë, Tedi i përkiste një bashkësie «pozitive». Në vend që të shqetësoheshin se mos Tedi do të prishte grupin e adoleshentëve të tjerë në kishë, ata, përkundrazi, e mirëpritën atë me dashuri dhe shqetësim në zemrat e tyre. Ata e deshën Tedin dhe u përpoqën ta kuptonin. I qëndruan pranë. Ata morën përsipër ta drejtojnë Tedin me butësi, edhe pse disa herë u desh të përballeshin me të. Fryma me të cilën e mësuan dhe matura që treguan në marrëdhëniet me të përçoi tek ai dashurinë e tyre të sinqertë.


Afrimi me dashuri ndaj Tedit bëri që ai të bëhej i krishterë. Ai nuk përfundoi në burg, por në të vërtetë u diplomua në një universitet kristian në degën e shërbimit kristian.

Bashkësia e Tedit komunikoi me të me anë të fjalëve dhe veprave të tilla që çdo bashkësi duhet t'u thotë të gjithëve: «Çdo anëtar i kësaj bashkësie besimtarësh ka vlerë, pavarësisht se sa i vogël, i dobët apo i shqetësuar mund të jetë.»

A janë njerëzit si Tedi pjesë e bashkësisë ku adhuroni? Ndërsa përgjigjeni «po», kujtoni fytyrat e tyre. I fiksoni ato në mendje. Pamja e tyre na tregon se pse Perëndia na thërret për të qenë ndërtues njerëzish.

KONKLuzion

Si do të reagoni ndaj udhëzimeve të Palit për të qenë «ndërtues njerëzish»? A do të kontrolloni fjalët që thoni? A do të siguroheni se po thoni atë që do të ngrejë shpirtërisht e moralisht të tjerët? A do t'i vini vetes si synim që t'i jepni përparësi ndihmës për të bërë mjedisin e bashkësisë lokale më të shëndetshëm e pozitiv? Po, duam që njerëzit të largohen prej mëkatit, por mënyra se si përpiqemi t'i ndihmojmë mund të çojë në dështim apo në sukses.

Dy sugjerime shumë praktike mund të ndihmojnë në këtë rast. *Së pari, shikoni Jezusin si shembull për të mësuar se si të jeni «ndërtues njerëzish».* Filloni me leximin e ungjijve dhe vëreni mënyrën se si komunikon Ai me njerëzit. *Së dyti, duke filluar që tani, merrni vendimin që t'i jepni përparësi inkurajimit të të tjerëve.* Për disa, fjalët inkurajuese dalin natyrshëm. Për shumicën prej nesh, duhet përvojë e përpjekje e vazhdueshme, por çdo gjë që bëjmë për ndërtimin e njerëzve ka vlerë të madhe. 

SHËNIME

¹ Kisha «pozitive»: Ato bashkësi që, kur ndonjë prej anëtarëve të tyre jepet pas mëkatit, nuk e braktisin atë, por pëpiqen ta ndihmojnë me të gjitha mundësitë për të rikthyer në zemrën e tij dedikimin ndaj Perëndisë.

² Kisha «negative»: Ato kisha që marrin pozicionin e gjykatësit, kur ndonjë nga anëtarët e tyre jepet pas mëkatit. Një nga mjetet që bashkësi të tilla përdorin për të «ndihmuar» vëllain apo motrën që po lufton me mëkatin është kërkesa për t'u shkëputur nga kisha, deri sa të zgjidhin problemin e mëkatit në jetën e tyre, pa bërë ndonjë përpjekje konkrete dhe serioze për t'i ndihmuar ata.

Autor: *Rusty Peterman*
Marrë nga seria: *“Efesianëve”*
© 2003 E VERTETA PER SOT
Të gjitha të drejtat të rezervuara